


VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
DOKUMENTI ËSHTË I PRAVNOSNAZMË
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr.1521/15

NË EMËR TË POPULLIT

31. 01. 2018



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - departamenti i përgjithshëm divizioni penal gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Hajri dhe sek. juridike, Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga [REDACTED], rr [REDACTED], komuna [REDACTED], për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.2382-4/14-A të dt.08.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestar me dt.11.12.2017 në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi ndërsa me datë 21.12.2017 përpiloi me shkrim, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], me nofkën [REDACTED] nga nga [REDACTED], komuna [REDACTED], i lindur [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i martuar, prind i dy fëmijëve, me profesion tregtar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 25.03.2014, në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Ferizaj, me dije e ka përdorur dokumentin e falsifikuar Autorizimin me numër LRP.nr. 1956/13 të datës 24.07.2013 kinse të lëshuar nga noteri Hajriz Bublaku me seli në Gllogovc, përmes të cilit dokument të falsifikuar ka bërë ç lajmërimin e veturës “Mercedes” modeli C240, me targë të regjistrimit [REDACTED], i regjistruar në emër të [REDACTED] të cilin pastaj ia ka shitur një personi nga Prishtina.

me të cilën kreu veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,23,41,43,46 dhe 73 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 700 (shtatëqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 28.04.2014 e deri më 26.05.2014.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

I dëmtuari [REDACTED] nga [REDACTED], rr. [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2382-4/14-A të dt.08.12.2015 e ka ngarkuar të pandehurin [REDACTED] për veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale me date 21.09.2017 mbajti shqyrtimin gjyqësor kryesor, në të cilën përfaqësuesi i akuzës – prokurori i shtetit Avdullah Abedini fillimisht lexoi aktin akuzues, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të datës 11.12.2017 në fjalën e tij përfundimtare ka mbet në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të saj, njëherit i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim të paraparë me ligj.

Gjyqtari individual pasi u bind se i pandehuri ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 të KPPK-së të akuzuarit i ofroi mundësin të pranoj fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor është deklaruar i pafajshëm për veprën penale me të cilën është ngarkuar, duke shtuar se veturën “Mercedes” e ka blerë nga personat e quajtur [REDACTED] dhe [REDACTED] të cilët i kanë thënë se në do ta rregullojmë gjithë procedure, i njëjti ka deklaruar se veturën e kishte blerë në vlerë prej 5,300 euro, duke shtuar se nuk e ka ditur se e kujt është kjo veturë ,ndërsa më pastaj, pasi që [REDACTED] dhe [REDACTED] ja kanë përkthyer veturën në emrin e tij ka deklaruar se të njëjtin veturë ja kishte shitur personit të quajtur [REDACTED] nga [REDACTED]. I pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se me [REDACTED] dhe [REDACTED] janë takuar tek piceria Delfini, ku [REDACTED] i ka thënë se e kishte siguruar autorizimin nga pronari dhe tani mund të shkojmë në qendrën e regjistrimit për ta regjistruar veturën, ku i pandehuri ka deklaruar se ka shkuar në qendrën e regjistrimit dhe aty kishte plotësuar formularin për çregjistrim të veturave dhe kishte bërë pagesat dhe pas dy – tre jave ka deklaruar se ka kuptuar nga policia se autorizimi është i falsifikuar.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit [REDACTED], i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.10.2017 ka deklaruar se është e vërtet se veturën e tij Mercedes 2.4 benzinë me ngjyrë të zezë e kishte marrë nga [REDACTED] pas marrëveshjes që ka pasur me të për kompensimin në bazë të punëve që ka bërë au në shtëpinë e tij. dëshmitari ka deklaruar se nga [REDACTED] kishte marr veturën

dhe vetëm kopjen e librezës së veturë dhe se nuk kishte marrë as letërnjoftimin e as kopjen e letërnjoftimit nga i dëmtuari [REDAKTUAR], ndërsa të njëjtën veturë ka deklaruar se e ka vozitur disa ditë dhe të njëjtën ja kishte shitur [REDAKTUAR].

Dëshmitari [REDAKTUAR], në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se veturën Mercedes me ngjyrë të zezë C klasë e kishte marrë me ndërrim nga kushëriri i tij [REDAKTUAR], për të cilën veturë ka deklaruar se ja kishte dhënë një veturë Pasat dhe një shumë parash prej 800 euro. Para se ta marr veturën nga [REDAKTUAR] dëshmitari, ka deklaruar se ka biseduar me [REDAKTUAR] djalin e të dëmtuarin [REDAKTUAR], i cili e kishte njoftuar se vetura nuk ka kurrfarë problem se lirisht mund ta blej dhe ka deklaruar se ka kërkuar letërnjoftimin nga ai, mirëpo djali i tij i kishte thënë se babait letërnjoftimi i ka humbur në Shqipëri, duke shtuar se me [REDAKTUAR] asnjëherë nuk ka biseduar dhe se edhe ai kur e ka blerë këtë veturë nuk ka pasur letërnjoftimin e as kopjen e letërnjoftimit të dëmtuarit [REDAKTUAR]. Dëshmitari ka deklaruar se këtë veturë ja kishte shitur pastaj vëllait të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] në vlerë prej 4,500 euro ku së bashku me veturë i kishte dorëzuar vetëm librezën e veturës dhe se nuk kishte pas kopje të letërnjoftimit. I njëjti ka deklaruar se pasi që kishte marrë veturën nga [REDAKTUAR] ka bërë përpjekje për përkthimin e veturës, mirëpo ky dëshmitar ka deklaruar se as i dëmtuari e [REDAKTUAR] e as djemtë e tij nuk kanë pranuar që ta bëjnë bartjen e veturës pasi që ashtu siç ishin marrë vesh me [REDAKTUAR], ky i fundit nuk i kishte kryer punët ashtu siç ishin marrë vesh. Dëshmitari ka deklaruar se kur ja kishte shitur veturën [REDAKTUAR] e kishte njoftuar se pronari i veturës nuk e jep pëlqimin për përkthimin e veturës për shkak të mosmarrëveshjeve që ka pasur me [REDAKTUAR] dhe këtë fakt ka deklaruar se e kishte ditur [REDAKTUAR] se vetura nuk e ka letërnjoftimin e pronarit dhe nuk mund të përkthehet.

Edhe i dëmtuari [REDAKTUAR] në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor të datës 11.12.2017, ka deklaruar se koha e saktë nuk i kujtohet mirëpo, diku para pesë viteve, veturën e tij të tipit Mercedes C Klas 240, e cila veturë ka qenë në emër të tij, mirëpo djali i tij [REDAKTUAR] kishte bërë një marrëveshje me [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], ku i është dhënë vetura Mercedes dhe një kamion skele në këmbim që i njëjti ta lyej me fasadë shtëpinë e tij. Dëshmitari ka deklaruar se [REDAKTUAR] ja kishte dhënë veturën Mercedes dhe vetëm librezën, mirëpo nuk ja kishte dhënë kopjen e letërnjoftimit e as kopjen e saj pasi që ishin marrë vesh që pas përfundimit të punëve të ja jap kopjen e letërnjoftimit, mirëpo pasi që asnjëherë [REDAKTUAR] nuk i kishte kryer punët ashtu siç ishin marrë vesh edhe i dëmtuari ka deklaruar se asnjëherë nuk ja kishte dhënë kopjen e letërnjoftimit. Po ashtu i dëmtuari ka deklaruar se asnjëherë, askujt nuk i kishte dhënë autorizim për ta vozitur, veturën e tij, e as të pandehurit [REDAKTUAR] nuk i kishte dhënë autorizim ndonjëherë për veturën e tij në zyrën e noterit Hajzer Bublaku.

Gjykata dëshmime të këtij dëshmitarëve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe të dëmtuarit [REDAKTUAR], i ka vlerësuar sit ë besueshme dhe të njëjtat janë të mbështetura në prova dhe fakte të cilat janë administruar në cilësinë e provës siç formulari për regjistrimin e automjeteve nga Agjencioni i regjistrimit civil- departamenti i regjistrimit të automjeteve dhe patentë shoferëve në Ferizaj i date 25.04.2014 ku shihet se i pandehuri ka bërë kërkesën pranë kësaj qendre dhe i njëjti formular është i nënshkruar nga vetë i pandehuri, pastaj autorizimi me nr.ref.LRP.1956/13 i përpiluar tek zyra e noterit Hajzer Bublaku në Glllogovc, e ku nga kopja e librit të përgjithshëm të

regjistrit nga noteri Hajzer Bublaku shihet se ky numrë dhe ky autorizim nuk është i regjistruar në këtë libër, kopja e fletëpagesës e datës 25.03.2014 së bashku me kopjen e librezës së regjistrimit të veturës Mercedes C 240 Class me nr. 05598-CV, kopja e letërnjoftimit të [REDAKTUAR], raporti informues i policisë nr. 06/1-02/1-FE/45/2004 si dhe në dokumentacionin tjetër që gjendet në shkresat e lëndës.

Mbrojtja e të pandehurit se nuk e ka kryer veprën është pabazuar nuk ka mbështetje në prova dhe fakte, dhe si e tillë më shumë e orientuar në drejtim të justifikimit të veprimeve të tij inkriminuese, me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe është shumë e qartë se i pandehuri dëshiron t'i shmanget përgjegjësisë penale. Po ashtu i pandehuri në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor e cila nga gjykata është vlerësuar si kontradiktore dhe jo konsistente me deklaratimet e tija të më para të dhëna sin ë fazën e procedurës penale e ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. I pandehuri ka qenë kontradiktor edhe me deklaratimet e tij fillimisht në deklaratën e tij të dhënë në polici me date 28.04.2014, kishte deklaruar se veturën ja kishte shitur një personi të quajtur [REDAKTUAR], ndërsa në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri ka deklaruar se veturën ja kishte shitur personit të quajtur [REDAKTUAR]. Po ashtu edhe gjatë mbrojtjes së tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se veturën e ka blerë nga personat [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], i cili deklarim është kontradiktor, pasi që i pandehuri në seancën dëgjimore për caktimin e paraburgimit të datës 30.04.2014 ka deklaruar se këtë veturë e kishte blerë nga vëllai i tij [REDAKTUAR], e që i njëjti deklarim se i pandehuri kishte blerë veturën nga [REDAKTUAR] është në përputhje dhe në harmoni të plotë edhe me dëshminë e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se veturën ja kishte shitur [REDAKTUAR], e të cilin e kishte njoftuar se vetura nuk ka letërnjoftimin e pronarit dhe e njëjta nuk mund të përkthehet.

Analizuar nga aspekti juridik në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK, të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, pasi që i pandehuri me datë 25.03.2014, pranë qendrës së regjistrimit të automjeteve në Ferizaj, me dije e ka përdorur dokumentin e falsifikuar Autorizimin me numër LRP.nr. 1956/13 të datës 24.07.2013 kinse të lëshuar nga noteri Hajriz Bublaku me seli në Glllogovc, përmes të cilit dokument të falsifikuar ka bërë ç lajmërimin e veturës "Mercedes" modeli C240, me targë të regjistrimit [REDAKTUAR], i regjistruar në emër të [REDAKTUAR] të cilin pastaj ia ka shitur një personi nga Prishtina.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit nenit 73 të KPPK-së, si rrethana lehtësuese gjykata mori faktin se nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, e ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Në bazë të këtyre rrethanave gjykata i caktoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i pandehuri në të ardhmen të mos kryejë vepra penale,

si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri.

Konform nenit 83 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar me gjobë i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 28.04.2014 e deri më 26.05.2014.

Konform nenit 463 par.par.2 të KPP-së i dëmtuari [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], rr. [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen. 450 par 2 pika 2.6 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

G.JYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-
departamenti i përgjithshëm divizioni penal
P.nr.1521/15 të dt. 21.12.2015

Sek.juridike
Drita Ujupi



KËSHILLA JURIDIKE – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.